



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:169393

Datë: 22.12.2022

Numri i dokumentit: 03790320

PPP.nr.54/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Nehat Qelaj me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit B. E., Sh.A me seli në P. Sh. “N. T.”, **tutje Kreditori**, kundër debitorit B. Z. nga fshati S., Komuna e M. (huamarrës-penglënës) - **tutje debitori**, për shkak të detyrimit në të holla- borxhin, në shumën totale, prej **602.85 €** (gjashtëqindë e dy euro e tetëdhjetë e tetë cent) i caktuar me Urdhrin për përmbarim të Përmbaruesit privat, Afet Mjeku nga Prishtina (**tutje Përmbaruesi**) me **P.nr.2514/20**, të dt.**30.09.2020**, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitorët e përmbarimit kundër këtij Urdhri për përmbarim, jashtë seancës gjyqësore, me dt.**22.12.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** si i pabazuar Prapësimi i ushtruar nga debitori B. Z. nga fshati S., Komuna e M. kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit me nr. **P.nr.2514/20**, të dt.**30.09.2020**, të Përmbaruesit privat, Afet Mjeku nga Prishtina me të cilin është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike të përmbarimit.
- II. Mbetet në fuqi** urdhri P.nr.2514/20, të dt.30.09.2020 i Përmbaruesit si më lart.

A r s y e t i m

Kreditori B. E., Sh.A me seli në P. sheshi “N. T.” në zyrën e përmbaruesit privat Afet Mjeku nga Prishtina si organ përmbarues ka paraqitur propozimin për përmbarim kundër debitorit B. Z. nga fshati S., Komuna e M. (huamarrës-penglënës) tutje debitori në bazë të marrëveshjes mbi mbitërheqjen, marrëveshjen mbi pengun, dhe vërtetimin për regjistrimin e pengut për shkak të detyrimit në të holla, në shumën totale prej 602.85 € (gjashtëqindë e dy euro e tetëdhjetë e tetë cent).

Përmbaruesi në këtë rast me Urdhër për përmbarim **P.nr.2514/20**, të dt.**30.09.2020**, e cakton përmbarimin e propozuar nga ana e kreditorit mirëpo me datë 08.11.2020 (sipas datës së dorëzimit në datë e protokolluar tek përmbaruesi) debitori ka parashtruar prapësim tek përmbaruesi ndaj Urdhrit të lartpërmendur duke e kontestuar në tërësi urdhërin përmbarues, po

ashtu ka deklaruar faktin se nuk është kontestues se me kreditorin kemi lidhur marrëveshjen mbi kredinë për individ dhe marrëveshjen mbi mbitërheqjen për personat fizik, kredinë për individ dhe marrëveshjen për pengun, deri në një kohë të caktuar, debitori- huamarrësi ka bërë pagesën e kredisë në mënyrë të rregullt dhe brenda afateve të caktuara sipas marrëveshjes, mirëpo për shkak të rrethanave të paraqitura debitorit – huamarrësit, rrethana për të cilat ka njoftuar edhe B. dhe vetë kreditorin, njëherit edhe ka kërkuar shtyrjen e afatit për pagesë, debitorët kanë rënë në vonesë dhe nuk kanë patur mundësi që të paguajnë këstet e kredisë, andaj debitori me anë të këtij prapësimi, propozon anulimin e urdhërit dhe pezullimin e procedurës lidhur me këtë çështje, dhe të mundësohet që të hyjë në marrëveshje për pagesën e kredisë- borxhit që ka ndaj kreditorit

Pas dërgimit të prapësimi të palës debitore, në afatin ligjor, përgjigjeje në prapësim ka paraqitur, kreditori i përmbarrimit duke theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit si të pa bazuara, për shkak se aktvendimi i cekur në prapësimin e ushtruar ndaj urdhërit përmbarrimor nuk është bazuar në dispozitat e ligjit në fuqi, ngase prapësimi i tij nuk përmban asnjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të ligjit për ushtrimin e prapësimi, gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të vazhdon procedura përmbarrimore sipas propozimit për përmbarrim.

Përmbarruesi duke vepruar më tej në këtë çështje juridike të përmbarrimit, me datë 03.11.2020, kësaj gjykate si organ kompetent i përmbarrimit ia ka dorëzuar shkresat e lëndës për të vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbarrimit kundër Urdhrit për përmbarrim **P.nr.2514/20, të dt.30.09.2020** të Përmbarruesit me të cilin urdhër është caktuar përmbarrimi në këtë çështje juridike të përmbarrimit.

Duke vlerësuar shkresat e lëndës e sidomos pretendimet e prapësimi të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të ushtruar nga kreditori, Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar.

Sipas nenit 71 të LPP-së, të Ligjit nr. 04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 të datës 31.01.2013, më tej LPP), janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi e të cilat shkaqe po që se ekzistojnë, pengojnë përmbarrimin e lejuar nga gjykata.

Gjykata vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarrimin e lejuar, në fakt dokumenti mbi të cilin është mbështetur Urdhri mbi lejimin e përmbarrimit ka titull ekzekutiv (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1), dokumenti përmbarrues (titulli ekzekutiv) nuk ka humbur efektin e tij me ndonjë vendim tjetër institucional, (neni 71. Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2) në bazë të cilit është marr me aktvendim përmbarrues nuk është prishur, anuluar apo ndryshuar, shfuqizuar në një mënyrë të tjetër dhe nuk e ka humbur efektin e tij juridik, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3) palët për mes dokumentit përmbarrues janë pajtuar që ti kryen obligimet e tyre për kohe të caktuar, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4) nuk ka skaduar afati kohor ku palët mund të kërkojnë përmbarrimin, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5) objekti i përmbarrimit nuk është i përjashtuar nga përmbarrimi i detyrueshëm, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6) kreditori është i autorizuar që në bazë të dokumentit përmbarrues të kërkojë përmbarrimin kundër debitorit, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9) realizimi i kredisë nuk është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër në mënyrë të përhershme ose për periudhën e kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk ka mundur të bënte të njohur në procedurë në të cilin

është nxjerrë vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdje në Gjykatë ose në organin administrativ, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10) kërkesa nga dokumenti përmbartues nuk është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve, e sidomos duke pasur parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, debitorët nuk kanë ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetët pretendimet e tyre, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së, sipas dispozitës të cekur është paraparë se provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim për ndryshe prapësimi do të refuzohet.

Gjykata konstatoj se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë si të sakta, pasi që prapësimin për përmbartim nuk ja ka bashkangjitur as edhe një provë të vetme me shkrim, e sipas nenit 69 par. 4 i cili thotë: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, sa i përket se propozimi për përmbartim është nxjerrë në kundërshtim me nenin 71 pika 1.1 të LPP-së dhe 29 pika 3 nuk qëndrojnë ngase kreditori propozimit për përmbartim ja ka bashkangjitur këto prova: marrëveshjen mbi mbitërheqjen për persona fizik nr.... të datës 08.05.2019 marrëveshjen mbi pengun nr.... të datës 08.05.2019 dhe vërtetimin për regjistrimin e pengut nr.... të datës 15.05.2022 ku të gjithat janë të nënshkruara në mes të kreditorit dhe debitorit janë të vulosura me vula origjinale te kreditorit, të nënshkruara në mes të kreditorit dhe debitorëve, andaj edhe të njëjtat pranohen si dokumente përmbartimore në kuptim të nenit 22 pika 1 paragraf 1.7 të LPP-së lidhur me nenin 5.2 ligji nr. 05/l-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-139 për procedurën përmbartimore, në këtë rast debitori deri më tani nuk ka dëshmuar se ka përmbushur detyrimin që ka ndaj kreditores.

Andaj në kuptim të nenit 5.5, 22 pika 1 paragraf 1.7 të LPP-së lidhur me nenin 5.2 ligji nr. 05/l-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-139 për procedurën përmbartimore, si dhe nenit 27 dhe 69 paragrafi 4, 71, dhe 73 paragrafi 3, të LPP-së dhe ligjit për plotësim ndryshim , u vendos si në dispozitiv të këtij AKTVENDIMI.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË
PPP.nr.54/20, me dt.22.12.2022

Gjyqtari
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.